



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 133 Datë 04.11.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III pika 3, germa ç .Këshilli Bashkiak vendosi me datë 04.11.2020 me 21 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 kat** në pronësi të z. **Lazam Losha** njësia administrative Muhurr (fshati Rreth - Kale) në shumën totale **1470165** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **1053365** lekë dhe vlera e dëmit orëndiak **416800** lekë.
3. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **73508** lekë (10% e 50 % të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar , sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 76 date 02.08.2017
4. Për pjesën tjetër të vlerës së patrajtuar, nga bashkia në masën 50 % të vlerës sipas nenit 41 të Ligjit Nr.45 date 18.07.2020 "Per Mbrojtjen Civile" dhe VKM Nr.329 date 16.05.2012, kreu III , pika 3, germa ç , diferenca për trajtim nga programi “*Emergjencave Civile*”, është **661574** leke.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

